





ITALIAN SCREENS

IL NUOVO CINEMA ITALIANO A TIRANA

12 - 16.04.2025
Kinema Millennium
Rr. Murat Toptani
Tirana





ITALIAN SCREENS - Il nuovo cinema italiano è una rassegna di film selezionati tra le più recenti produzioni italiane.

Per questa edizione sono stati scelti quattro film, diversi per genere e ambientazione: ***Gloria!*** di **Margherita Vicario**; ***La bicicletta di Bartali*** di **Enrico Paolantonio**; ***Il tempo che ci vuole*** di **Francesca Comencini**; ***Ciao bambino*** di **Edgardo Pistone**; ***Diamanti*** di **Ferzan Ozpetek**; ***La Chimera*** di **Alice Rohrwacher**.

I film saranno presentati dal **12 al 16 aprile** al Cinema Millennium a Tirana (Rruga Murat Toptani), in lingua italiana con sottotitoli in inglese. L'ingresso è libero.

Italian Screens è un'iniziativa pensata per presentare il meglio del cinema italiano ed è promossa dal **Ministero degli Affari Esteri e della Cooperazione Internazionale**, da **Cinecittà** e dalla **Direzione Generale Cinema e Audiovisivo del Ministero della Cultura**.

Italian Screens rappresenta un'opportunità fondamentale per promuovere il cinema italiano all'estero, mettendo in luce i protagonisti del nostro settore e attirando un pubblico internazionale capace di apprezzare le grandi produzioni contemporanee. Allo stesso tempo, la rassegna offre una vetrina esclusiva per presentare agli operatori esteri il meglio dell'audiovisivo italiano, con l'obiettivo di stimolare le coproduzioni, favorire l'innalzamento degli standard professionali e contribuire all'internazionalizzazione del nostro cinema. Inoltre, Italian Screens si configura come una preziosa occasione di networking, permettendo agli attori del settore di entrare in contatto con i principali interlocutori in grado di illustrare il programma di incentivi nazionali e regionali, destinati a supportare le produzioni che scelgono di girare in Italia.

ITALIAN SCREENS - Kinemaja e re italiane ofron një buqetë filmash të përzgjedhur ndër produksionet italiane më të fundit.

Për këtë edicion janë zgjedhur gjashtë filma, të ndryshëm në zhanër dhe ambientim: ***Gloria!*** nga **Margherita Vicario**; ***La bicicletta di Bartali*** nga **Enrico Paolantonio**; ***Il tempo che ci vuole*** nga **Francesca Comencini**; ***Ciao bambino*** nga **Edgardo Pistone**; ***Diamanti*** nga **Ferzan Ozpetek**; ***La Chimera*** nga **Alice Rohrwacher**.

Filmat do të shfaqen nga data **12 deri më 16 prill** pranë Kinema Millennium në Tiranë (Rruga Murat Toptani), në gjuhën italiane me titra në anglisht. Hyrja do të jetë e lirë.

Italian Screens është një nismë e ideuar për të prezantuar më të mirën e kinemasë italiane, e promovuar nga **Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar**, nga **Cinecittà** dhe nga **Drejtoria e Përgjithshme e Kinemasë dhe Sektorit Audioviziv të Ministrisë së Kulturës**.

Italian Screens paraqet një mundësi thelbësore për t'i bërë të njohur jashtë vendit protagonistët e kinemasë italiane, për të krijuar një audiencë që vlerëson produksionet e shkëlqyera të momentit, por edhe për t'u prezantuar operatorëve vendas më të mirën e asaj që ofron sistemi audioviziv italian, me qëllim inkurajimin e bashkëprodhimeve, rritjen e cilësisë profesionale të industrisë dhe ndërkombëtarizimin e kinemasë. Ky aktivitet përfaqëson gjithashtu një mundësi të rëndësishme network-u për të lejuar operatorët e sektorit të hyjnë në kontakt me ata që mund t'u ilustrojnë më së miri programin nxitës në nivel kombëtar dhe rajonal, në mbështetje të produksioneve që zgjedhin të kryejnë xhirimet e filmave në Itali.

ITALIAN SCREENS

IL NUOVO CINEMA ITALIANO A TIRANA



CALENDARIO



12.04.2025 ore 19:00

Gloria!
di **Margherita Vicario**

Con: Galathea Bellugi, Carlotta Gamba,
Veronica Lucchesi, Mariavittoria Dallasta.
Drammatico | Italia-Svizzera, 2024 | 100'



Margherita Vicario

Venezia, collegio femminile di fine '700. Insieme a un gruppetto di straordinarie musiciste Teresa, una giovane dal talento visionario, scavalca i secoli e sfida i polverosi catafalchi dell'Ancien Régime inventando una musica ribelle, leggera e moderna.

Venecia, një kolegji femrash në fund të Shtatëqindës. Së bashku me një grup të vogël muzikantesh të jashtëzakonshme, Teresa, një grua e re me talent vizionar, kapërcen shekujt dhe sfidon katafalkët e pluhurosur të Ancien Régime, duke krijuar një muzikë rebele, të lehtë dhe moderne.

Gloria!, uscito nelle sale italiane ma già in gara per l'Orso d'oro a Berlino, rappresenta l'esordio alla regia di **Margherita Vicario**, romana classe 1988, attrice e cantautrice, tra le più interessanti firme del circuito musicale indipendente. Debutta al cinema nel 2012 con un regista da urlo. È infatti Woody Allen a dirigerla nel film "To Rome with Love". Da quel momento la strada del successo è ben delineata e Margherita colleziona una dietro l'altra ampie soddisfazioni.

Gloria!, e shfaqur në sallat italiane dhe tashmë në garë për çmimin Ariu i Artë në Berlin, përfaqëson debutimin regjisorial të **Margherita Vicario-s**, aktore dhe kantautore romane e lindur në vitin 1988, një nga emrat më interesante në qarkun e pavarur muzikor. Ajo bëri debutimin e saj në film në vitin 2012 me një regjisor të mirënjohur. Ishte në fakt Woody Allen ai që e drejtoi në filmin "To Rome with Love". Që nga ai moment, rruga drejt së ardhmes u ravijëzua dhe Margherita ka arritur të korrë suksese të njëpasnjëshme.



13.04.2025 ore 17:00

La bicicletta di Bartali di Enrico Paolantonio

Animazione | Italia-India-Irlanda, 2024 | 80'



Protagonista della storia è la bicicletta con cui Gino Bartali trasportò documenti falsi per salvare centinaia di ebrei dalla barbarie nazifascista nella Toscana del 1943-44. A Gerusalemme, sessant'anni dopo, la bicicletta di Bartali diventa il simbolo dell'avventura di David, un giovane ciclista ebreo israeliano che fa amicizia con Ibrahim, un ragazzo arabo israeliano con cui instaura una forte complicità e sogna di vincere un campionato di ciclismo, violando le regole ma portando pace e tolleranza nelle rispettive comunità. Il percorso non sarà privo di ostacoli ma attraverso lo sport i due giovani amici impareranno il rispetto reciproco, la collaborazione, il sacrificio, riconoscendosi l'uno nell'altro e costruendo un legame profondo in grado di superare le divisioni imposte dalla società.

Protagoniste e historisë është biçikleta me të cilën Gino Bartali transportonte dokumente false për të shpëtuar qindra hebrenj nga barbaria nazi-fashiste në Toskanën e viteve 1943-44. Në Jerusalem, gjashtëdhjetë vjet më pas, biçikleta e Bartali-t shndërrohet në simbol të aventurës së Davidit, një çiklist i ri hebre izraelit, që miqësohet me Ibrahim, një djalë arab izraelit, me të cilin krijon një bashkëpunim të fortë dhe ëndërron të fitojë kampionatin e çiklizmit, duke thyer rregullat, por duke sjellë paqe dhe tolerancë në komunitetet e tyre përkatëse. Rrugëtimi nuk do të jetë pa pengesa, por përmes sportit dy miqtë e rinj, do të mësojnë respektin e ndërsjellë, bashkëpunimin dhe sakrificën, duke njohur njëri-tjetrin dhe duke ndërtuar një lidhje të thellë, e aftë të kapërcejë ndarjet e imponuara nga shoqëria.

Enrico Paolantonio



Enrico Paolantonio (nato a Roma nel 1969) è un regista e animatore italiano. Dopo aver conseguito la qualifica di Tecnico dell'Animazione e il diploma in Arti applicate alla Cinematografia presso l'Istituto Statale di Cinematografia "R. Rossellini" di Roma, ha lavorato in studi di animazione e come fumettista. Nel 1994 ha co-fondato Musicartoon, curando la regia di serie e film d'animazione, tra cui "Gibi & Doppiaw", "Le straordinarie avventure di Jules Verne" e "La bicicletta di Bartali" (2024).

Enrico Paolantonio (lindur në Romë në 1969) është regjisor dhe animator italian. Pas kualifikimit si Teknik Animacioni dhe diplomës në Arte të Aplikuara Kinematografike pranë Institutit Shtetëror të Kinematografisë "R. Rossellini" në Romë, ai punoi në studio animacioni edhe si shkrimtar tregimesh viazatimorë. Në vitin 1994 bashkëthemeloi Musicartoon, duke drejtuar serialë dhe filma të animuar, mes të cilëve "Gibi & Doppiaw", "Le straordinarie avventure di Jules Vern" dhe "La bicicletta di Bartali" (2024).




13.04.2025 ore 19:00

Il tempo che ci vuole di Francesca Comencini

Con Fabrizio Gifuni, Romana Maggiora Vergano,
Anna Mangiocavallo, Luca Donini.

Drammatico | Italia, 2024 | 110'



Francesca Comencini

Film autobiografico, è un racconto personale di alcuni momenti trascorsi dalla regista con suo padre. Si racconta il viaggio interiore di una donna che, dopo la fine di una relazione importante, cerca di ricostruire sé stessa. Alternando passato e presente, il film esplora il dolore della separazione, i ricordi felici e il processo di guarigione emotiva, mostrando come il tempo sia fondamentale per accettare il cambiamento e ritrovare un nuovo equilibrio nella vita.

Një film autobiografik, i cili përfaqëson një rrëfim personal të regjisores mbi disa momente të kaluara me të atin. Tregohet rrugëtimi i brendshëm i një gruaje, e cila pas përfundimit të një lidhjeje të rëndësishme, përpiqet të rindërtojë veten. Duke alternuar të shkuarën dhe të tashmen, filmi eksploron dhimbjen e ndarjes, kujtimet e lumtura dhe procesin e shërimit emocional, duke treguar se si koha është thelbësore për të pranuar ndryshimin dhe për të gjetur një ekuilibër të ri në jetë.

Francesca Comencini (nata a Roma nel 1961) è una regista, sceneggiatrice e scrittrice italiana. Figlia del celebre regista Luigi Comencini, ha esordito nel cinema con "Pianoforte" (1984), vincendo il Premio De Sica a Venezia. Ha diretto film e serie TV di successo, tra cui "Le parole di mio padre" (2001), "Mi piace lavorare (Mobbing)" (2004) e "Gomorra - La serie". Il suo cinema esplora spesso tematiche sociali e femminili.

Francesca Comencini (lindur në Romë në 1961) është regjisorë, skenariste dhe shkrimtare italiane. Vajza e regjisorit të famshëm Luigi Comencini, ajo debutoi me filmin e saj "Pianoforte" (1984), duke fituar çmimin De Sica në Venecia. Ka drejtuar filma dhe serialë televizivë të suksesshëm, ku përmendim "Le parole di mio padre" (2001), "Mi piace lavoro (Mobbing)" (2004) dhe "Gomorra - La serie". Kinemaja e saj eksploron shpesh tema sociale dhe të lidhura me botën femërore.




14.04.2025 ore 19:00

Ciao bambino di Edgardo Pistone

Con: Marco Adamo, Anastasia Kaletchuk,
Luciano Pistone, Pasquale Esposito, Salvatore
Pelliccia.

Drammatico | Italia, 2024 | 95'



Edgardo Pistone

Il film è ambientato alla fine dell'estate e segue le vicende di un ragazzo di 19 anni di nome Attilio, che vive nel rione Traiano, a Napoli. Il giovane viene incaricato di proteggere una prostituta dell'Est, ma ben presto finisce per innamorarsene. Attilio, però, è costretto dalle circostanze a tenere i suoi sentimenti segreti. Una volta che suo padre esce dal carcere, perseguitato dagli strozzini, il ragazzo dovrà ripagare un debito consistente e si ritroverà costretto a scegliere tra la ragazza che ama e il genitore, mettendo in gioco la sua libertà e tutta quella che è stata la sua vita.

Filmi zhvillohet në fund të verës dhe ndjek aventurat e një djali 19-vjeçar të quajtur Attilio, i cili jeton në lagjen Traiano të Napolit. I riu caktohet të mbrojë një prostitutë nga Lindja, por shpejt përfundon duke rënë në dashuri me të. Megjithatë, ai është i detyruar nga rrethanat t'i mbajë të fshehta ndjenjat. Pasi lirimit nga burgu të të atit, i persekutuar nga fajdexhinjtë, djalit do t'i duhet të shlyejë një borxh të konsiderueshëm dhe do ta gjejë veten të detyruar të zgjedhë mes vajzës që dashuron dhe prindit, duke vënë në rrezik lirinë dhe krejt jetën e tij.

Edgardo Pistone, nato a Napoli nel 1990, è un regista e sceneggiatore italiano. Ha vinto il premio per la Miglior Regia alla Mostra del Cinema di Venezia 2020 con il corto "Le mosche". Nel 2024 ha debuttato nel lungometraggio con "Ciao Bambino", premiato al Black Nights Film Festival di Tallinn e a Roma Film Festival.

Edgardo Pistone, lindur në Napoli në vitin 1990, është regjisor dhe skenarist italian. Ai fitoi çmimin e regjisorit më të mirë në Festivalin e Filmit në Venecia 2020 me filmin me metrazh të shkurtër "Le mosche". Në vitin 2024, debutoi me filmin artistik "Ciao Bambino", i vlerësuar në Festivalin e Filmit Black Nights në Talin dhe në Festivalin e Filmit në Romë.



15.04.2025 ore 19:00

Diamanti di Ferzan Özpetek

Con: Luisa Ranieri, Jasmine Trinca, Stefano Accorsi, Luca Barbarossa (II), Sara Bosi.
Commedia, Drammatico | Italia, 2024 | 135'



Ferzan Özpetek



Un regista convoca le sue attrici preferite, quelle con cui ha lavorato e quelle che ha amato. Vuole fare un film sulle donne ma non svela molto: le osserva, prende spunto, si fa ispirare, finché il suo immaginario non le catapulta in un'altra epoca, in un passato dove il rumore delle macchine da cucire riempie un luogo di lavoro gestito e popolato da donne, dove gli uomini hanno piccoli ruoli marginali e il cinema può essere raccontato da un altro punto di vista: quello del costume. Tra solitudini, passioni, ansie, mancanze strazianti e legami indissolubili, realtà e finzione si compenetrano, così come la vita delle attrici con quella dei personaggi, la competizione con la sorellanza, il visibile con l'invisibile.

Një regjisor thërret aktoret e tij të preferuara, ato me të cilat ka punuar dhe është dashuruar. Synon të bëjë një film për gratë, por nuk iu zbulon shumë: i vëzhgon, nxitet dhe frymëzohet derisa imagjinata e tij i çon në një epokë tjetër, në një të kaluar ku zhurma e makinave qepëse mbush një vend pune të drejtuar dhe të populluar nga gra, ku burrat kanë role të vogla, marginale dhe kinemaja mund të tregohet nga një këndvështrim tjetër: ai i zakoneve. Mes vetmisë, pasioneve, anktheve, mungesave zemërthyesë dhe lidhjeve të pazgjithshme, realiteti dhe fiction-i ndërthuren, ashtu siç ndërthuret jeta e aktoreve me atë të personazheve, konkurrenca me vëllazërinë, e dukshmja me të padukshmen.

Ferzan Özpetek (Istanbul, 1959) è un regista e sceneggiatore turco naturalizzato italiano. Dopo essersi trasferito a Roma per studiare cinema, ha esordito con "Il bagno turco" (1997), ottenendo successo internazionale. Tra i suoi film più noti ci sono "Le fate ignoranti" (2001), "La finestra di fronte" (2003) e "Mine vaganti" (2010), con cui ha vinto numerosi premi. Le sue opere esplorano temi come l'identità, l'amore e le dinamiche familiari, con uno stile emozionale e raffinato. Ha lavorato anche in teatro e pubblicato romanzi di successo.

Ferzan Özpetek (Stamboll, 1959) është regjisor dhe skenarist turk i natyralizuar italian. Pasi u transferua në Romë për të studiuar kinema, ai debutoi me "Il bagno turco" (1997), duke arritur sukses ndërkombëtar. Ndër filmat e tij më të njohur janë "Le fate ignoranti" (2001), "La finestra di fronte" (2003) dhe "Mine vaganti" (2010), me të cilët fitoi çmime të shumta. Veprat e tij eksplorojnë tema të tilla si identiteti, dashuria dhe dinamikat e familjes, me një stil emocional dhe të rafinuar. Ka punuar gjithashtu në teatër, si dhe ka botuar romane të suksesshme.



16.04.2025 ore 19:00

La Chimera di Alice Rohrwacher

Con: Josh O'Connor, Carol Duarte, Vincenzo Nemolato, Alba Rohrwacher, Isabella Rossellini.
Drammatico | Italia, 2023 | 134'



Alice Rohrwacher

“La Chimera” è un film che segue la storia di Arthur, un giovane archeologo inglese che, negli anni '80, si unisce a un gruppo di tombaroli in Italia per trafugare antichi reperti etruschi. Mentre si muove tra il mondo della legalità e dell'illegalità, Arthur è tormentato dal ricordo di un amore perduto e dalla ricerca di un equilibrio tra il passato e il presente. Il film esplora il desiderio, la perdita e il rapporto tra l'uomo e la storia, in un'atmosfera sospesa tra realismo e magia.

“La Chimera” është një film që ndjek historinë e Arturit, një arkeologu i ri anglez, i cili, në vitet 1980, bashkohet me një grup grabitësish varresh në Itali, për të vjedhur artefakte të lashta etruske. Ndërsa lëviz midis botëve të ligjshmërisë dhe paligjshmërisë, Arturin e mundon kujtimi i një dashurie të humbur dhe kërkimi i një ekuilibri mes të shkuarës dhe të tashmes. Filmi eksploron dëshirën, humbjen dhe marrëdhëniet mes njeriut dhe historisë, në një atmosferë pezull mes realizmit dhe magjisë.

Alice Rohrwacher (Firenze, 1981) è una regista e sceneggiatrice italiana. Dopo aver studiato cinema e regia, ha esordito nel 2008 con il cortometraggio “È stato il figlio”. Il suo primo lungometraggio, “Corpo celeste” (2011), ha ottenuto riconoscimenti internazionali. È famosa per il film “Le meraviglie” (2014), che ha vinto il Gran Prix al Festival di Cannes. I suoi lavori sono caratterizzati da uno stile poetico e realistico, che esplora tematiche legate alla famiglia, alla natura e alla memoria.

Alice Rohrwacher (Firenze, 1981) është regjisorë dhe skenariste italiane. Pas studimeve për kinema dhe regji, debutoi në vitin 2008 me filmin me metrazh të shkurtër “È stato il figlio”. Filmi i saj i parë artistik, “Corpo celeste” (2011), u vlerësua në arenën ndërkombëtare. Është e famshme për filmin “The Wonders” (2014), i cili fitoi Çmimin e Madh në Festivalin e Filmit në Kanë. Veprat e saj karakterizohen nga një stil poetik dhe realist, i cili eksploron tema që lidhen me familjen, natyrën dhe kujtesën.



CINECITTÀ

